#### Outlook 2013

# KONFIGURIMI I ADRESËS E-MAIL NË OUTLOOK 2013



## - Leksion shtesë në ECDL 2013 për Outlook 2013

ECDL 2013 nuk e parashikon konfigurimin e adresës e-mail për *Outlook 2013*. Ne mendojmë se kjo është mjaft e rëndësishme dhe me interes për t'u ditur, pasi mund të bëhet e mundur, që të gjitha adresat e-mail të shfrytëzohen nga i njëjti program klient e-maili, siç është *Outlook 2013*.

Për këtë arsye, në vijim do të sqarojmë mënyrën se si mund të konfiguroni një adresë normale email, kur dihet adresa e-mail dhe fjalëkalimi i saj, si dhe informacioni i duhur i komunikimit me mail-serverin, si **POP3** (*Post Office Protocol 3 – protokolli 3 i postës zyrtare*) dhe **SMTP** (*Simple Mail Transfer Protocol – protokolli i transferimit të postës së thjeshtë*). Këto të dyja janë protokollet kryesore të serverit për postime elektronike. Por ka edhe një protokoll, që e zëvendëson POP3. Ai është **IMAP** (*Internet Message Access Protocol – protokolli i hyrjes së mesazhit në internet*).

- 1. Konfigurimi i një adrese normale e-mail në Outlook 2013
- 2. Konfigurimi i adresës në Hotmail për Outlook 2013 (f. 3)
- 3. Konfigurimi i adresës në Gmail për Outlook 2013 (f. 4)

## 1. Konfigurimi i një adrese normale e-mail me POP3 në Outlook 2013

Për të konfiguruar një adresë normale e-mail në *Outlook 2013*, veprojmë në këtë mënyrë: Klikojmë menynë **File** (*filet*) në krye të programit, me ngjyrë blu, në të majtë. Hapet kolona e menysë *filet* me pamjen e mëposhtme:



Klikojmë më pas në butonin **Add Account** + Add Account (*shto llogari*). Në dritaren që hapet, në fund, shënjojmë dhe zgjedhim **Manual setup or additional server types** (*instalim manual ose tipe serveri shtesë*). Klikojmë butonin **Next** > (*tjetër*).

Manual setup or additional server types			
	< Back	Next >	Cancel

#### Në dritaren që vijon, zgjedhim POP or IMAP, si më poshtë:

Add Ac	count ×
Choose Service	****
<ul> <li>Microsoft Exchange Server or compatible service</li> <li>Connect to an Exchange account to access email,</li> <li>Outlook.com or Exchange <u>ActiveSync compatible</u></li> <li>Connect to a service such as Outlook.com to access</li> </ul>	calendars, contacts, tasks, and voice mail <b>service</b> ss email, calendars, contacts, and tasks
POP or IMAP     Connect to a POP or IMAP email account	
	< <u>B</u> ack <u>N</u> ext > Cancel

Pastaj, përsëri **Next >** (*tjetër*). Dhe në dritaren që vijon, ...**Account Settings** (*rregullimet e llogarisë*), bëjmë plotësimin e fushave të kërkuara, si më poshtë:

lleer lefermelien		Tank Associate Cattioner
Your Name:	Arben Çokaj	We recommend that you test your account to ensure tha the entries are correct.
Account Type:		<u>T</u> est Account Settings ✓ Automatically test account <u>s</u> ettings when Next
Outgoing mail server (SMTP):	mail.shkoder.net	is clicked Deliver new messages to:
<u>U</u> ser Name: Password:	acokaj@shkoder.net	C Existing Outlook Data File
-	member password e Password Authentication	More Settings

Pastaj klikojmë përsëri **Next** > (*tjetër*). Programi *Outlook 2013* do të fillojë testimin e adresës e-mail të dhënë, nëse gjithçka funksionon. Nëse të dhënat tona për e-mailin janë në rregull, programi do të pyesë, nëse duam të shtojmë një adresë tjetër e-mail, apo ta mbyllim programin me **Finish** (*përfundo*). Me kaq shtohet një adresë e-mail në llogarinë e *Outlook 2013*.

**Shënim**: Kur jepet **Outgoing mail server** (**SMTP**), ndodh që mesazhi me e-mail nuk mund të dërgohet me serverin normal. Kjo vjen për shkak se konfigurimi i serverit të postës dalëse varet nga ISP, që të ofron internetin, dhe duhet pyetur ISP, cili është konfigurimi SMTP në këtë rast.

## 2. Konfigurimi i adresës në Hotmail me Outlook 2013

Si fillim shkarkojmë ndërlidhësin e Outlook me Hotmail, të zhvilluar nga Microsoft, duke kërkuar në varësi të sistemit, që kemi: Outlook Hotmail Connector **32-bit** apo Outlook Hotmail Connector **64bit**. Instalojmë kështu **OutlookConnector.exe**, që e shkarkuam nga interneti, pastaj fillojmë procedurën e konfigurimit të adresës e-mail në Outlook 2013, që kemi nga Hotmail.

Për të konfiguruar një adresë të *Hotmail* me *Outlook 2013*, ndjekim të njëjtën procedurë si më sipër, por në dritaren **Choose Service** (*zgjedh shërbimin*), zgjedhim **Outlook.com or Exchange ActiveSync compatible service** (*Outlook.com ose Exchange ActiveSync shërbim në përshtatje*).

Add Account	×
Choose Service	×
<ul> <li>Microsoft Exchange Server or compatible service</li> <li>Connect to an Exchange account to access email, calendars, contacts, tasks, and voice mail</li> <li>Outlook.com or Exchange ActiveSync compatible service</li> <li>Connect to a service such as Outlook.com to access email, calendars, contacts, and tasks</li> </ul>	
POP or IMAP Connect to a POP or IMAP email account	Consel
< <u>B</u> ack <u>N</u> ext >	Cancel

Klikojmë **Next** > (*tjetër*) dhe më pas na shfaqet dritarja **Server Settings** (*rregullimet e serverit*), ku bëjmë një plotësim disi më ndryshe, në varësi të serverit të *Hotmail*:

	Add Account	>
Server Settings Enter the informa	tion that is required to connect to an Exchange ActiveSync service.	芯
User Information		
Your Name:	Arben Çokaj	
E-mail Address:	acokaj@hotmail.com	
Server Information		
Mail server:	m.hotmail.com	
Logon Information		
User Name:	acokaj@hotmail.com	
Password:	*****	
	Remember password	
Offline Settings		
Mail to keep offline:	All	
	< <u>B</u> ack <u>N</u> ext > (	Cancel

Klikojmë përsëri Next > (tjetër) dhe nëse të dhënat i kemi në rregull, gjithçka do të shkojë si duhet.

#### 3. Konfigurimi i adresës në Gmail me Outlook 2013

Për të konfiguruar një adresë e-mail të *Gmail* me *Outlook 2013*, shkojmë tek rregullimet e adresës sonë Gmail në ueb, dhe zgjedhim konfigurim sipas **IMAP**. Bëjmë zgjedhjet, që tregohen në figurë:

General Labels Inbox	Accounts Filters Forwarding and POP/IMAP Chat Web Clips 5. Configure your enter clear (e.g. Cultoux, Europa, Netscape Mail) Configuration instructions
IMAP Access: (access How-To Geek Mail from other clients using IMAP) Learn more	Status: IMAP is disabled Enable IMAP Disable IMAP
	When I mark a message in IMAP as deleted: Auto-Expunge on - Immediately update the server. (default) Auto-Expunge off - Wait for the client to update the server.
	When a message is marked as deleted and expunged from the last v ● Archive the message (default) ● Move the message to the Trash ● Immediately delete the message forever
	Folder Size Limits ● Do not limit the number of messages in an IMAP folder (default) ○ Limit IMAP folders to contain no more than this many messages 1,000
	Configure your email client (e.g. Outlook, Thunderbird, iPhone) Configuration instructions
	Save Changes Cancel
0 GB (0%) of 15 GB used	©2013 Gooole - Terms of Service - Privacy Policy - Program

Dhe në fund klikojmë **Save Changes** (*ruaj ndryshimet*). Pastaj i hyjmë konfigurimit të adresës e-mail në *Outlook 2013*, duke ndjekur procedurën si në *pikën 1*, për konfigurimin e një adrese normale. Por kur mbërrijmë në ...**Account Settings** (*rregullimet e llogarisë*), për **Account Type** (*tipi i llogarisë*), zgjedhim **IMAP** në vend të *POP3*, dhe bëjmë plotësimet e duhura, si më poshtë:

Your Name:       Arben Çokaj       We recommend that you test your account to ensure the entries are correct.         Email Address:       acokaj@gmail.com       Test Account Settings         Server Information       Incoming mail server:       imap.gmail.com         Jncoming mail server:       imap.gmail.com       Imap.gmail.com         Qutgoing mail server (SMTP):       smtp.gmail.com       Imap.gmail.com         Logon Information       User Name:       acokaj@gmail.com         Bassword:       ************************************	User Information		Test Account Settings
Email Address:       acokaj@gmail.com         Server Information       Iest Account Settings         Account Type:       IMAP         Incoming mail server:       imap.gmail.com         Qutgoing mail server (SMTP):       smtp.gmail.com         Logon Information       Isotopage         User Name:       acokaj@gmail.com         Password:       ************************************	Your Name:	Arben Çokaj	We recommend that you test your account to ensure th
Server Information       IMAP       Iest Account Settings         Account Type:       IMAP       ✓         Incoming mail server:       imap.gmail.com       ✓         Outgoing mail server (SMTP):       smtp.gmail.com       ✓         Logon Information           User Name:       acokaj@gmail.com       Mail to keep offline: All         Password:       **********	<u>E</u> mail Address:	acokaj@gmail.com	the entries are correct.
Logon Information User Name: acokaj@gmail.com Password: **********	Server Information Account Type: Incoming mail server: Outgoing mail server (SMTP):	IMAP	<u>Test Account Settings</u> ✓ Automatically test account <u>s</u> ettings when Next is clicked
User Name: acokaj@gmail.com Mail to keep offline: All	Logon Information	Sincpagnanicom	
	<u>U</u> ser Name: <u>P</u> assword:	acokaj@gmail.com	Mail to keep offline: All
	<u> </u>	emember password	

Klikojmë **More Settings** ... (*më tepër rregullime*) dhe japim vlerat e duhura, që kërkohen nga serveri *Gmail*, për tabelorin **Outgoing server** (*serveri i daljes*), si më poshtë:

Internet E-mail Settings	×
General Outgoing Server Advanced	
✓ My outgoing server (SMTP) requires authentication ● Use same settings as my incoming mail server	
O Log on using	
User <u>N</u> ame:	
Password:	
✓ <u>R</u> emember password	
Reguire Secure Password Authentication (SPA)	
OK Can	el

Dhe tek tabelori Advanced (avancuar), bëjmë plotësimet që vijojnë, si në figurën më poshtë:

Internet E-mail Settings		
General Outgoing Server Advanced		
Server Port Numbers		
Incoming server (IMAP): 993 Use Defaults		
Use the following type of <u>encrypted connection</u> : SSL		
Outgoing server (SMTP): 587		
Use the following type of encrypted connection: TLS		
Server Timeouts		
Short — Long 1 minute		
Folders		
Root <u>f</u> older path:		
Sent Items		
Do not save copies of sent items		
Deleted Items		
Mark items for deletion but do not move them automatically		
Items marked for deletion will be permanently deleted when		
✓ Purge items when switching folders while online		
OK Cancel		

Kështu, adresa në Gmail do të fillojë të marrë dhe dërgojë e-maile nga Outlook 2013.

Në të njëjtën mënyrë mund të konfigurojmë edhe një adresë në **Yahoo.com** për të punuar *me Outlook 2013*, por duhet të shikohen *konfigurimet e kërkuara*, që mund të gjenden duke kërkuar në internet. Kërkojmë psh. *Yahoo account to Outlook 2013* dhe shikojmë rezultatet që marrim.